



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-II-14-0049

1. A. Z

Paditësit

2. N. Z, nga Prizreni, nga av **B. N**, Prizren.

Kundër:

e paditura/ Ankuesit

NSH, KBI “P”, Prizren, të përfaqësuar nga: **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. “Agim Ramadani” nr.23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr.347/03 të datës 07/05/2009, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 16/07/2020 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1.** Ankesat e të paditurave janë të bazuara.

2. Anulohet ,Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr. 347/03 të datës 07/05/2009.
3. Lënda dërgohet për rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 13 qershor 2003, paditësit kishin parashtruar padi pronësore në Gjykatën Komunale të Prizrenit. Paditësit në padi kërkonin ndërrimin dhe dorëzimin të ngastrave kadastrale, të cilat evidentohen si ngastra kadastrale nr.5403 në vendin e quajtur “L”, në sipërfaqe prej 44.93 ari dhe ngastrën kadastrale nr. 5106 në vendin e quajtur “K”, në sipërfaqe prej 7 ari, duke kërkuar dorëzimin e paluejtshmërisë – ngastrave kadastrale kontestuese.

Ata pohuan se me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale Prizren C.nr. 383/95 të datës 21/12/1995, Kontrata e shitblerjes ndemjet A. A. Z dhe K “P” Prizren e lergalizuar nr. 1898/63 te datës 11/11/1963 ishte shapllur Nul dhe ishte obliguar e paditura që shitësit A1 Z nga Prizreni t'i kthejë ne pronësi dhe posedim ngastrën kadastrale nr. 40 , fleta poseduese nr. 94 KK Petrovë ne sipërfaqe prej 95.46 ari në kufij nga veriu dhe jugu prej 47.40 m, nga lindja prej 203.3 m dhe nga perëndimi 222,00 m.

Padisë i bashkëngjitën Aktgjykimin C.nr. 383/95 të datës 21/12/1995 Kontratën mbi ndërrimin nr. 10659/9 të datës 17/02/1967 ndërmjet R. A F dhe K “P” Prizren, Kontratën e shitblerjejes nr. 11647/491 të datës 09 nëntor 1963, Konstatimin e ekspertitit financiar, konstatimin e ing. konstatimin e ekspertit gjeodet, listën poseduese nr. 8417 të datës 18/04/1990, Certifikaten e vdekjes për A. Z, Certifikatën e lindjes për A. Z, Certifikatën e lindjes për N. Z Kontratën e shitblerjes të datës 28/08/1962 ndërmjet A. Z dhe “K” Prizren lidhur ngastrat kadastrale nr. 5403 fleta poseduese 1102 Komuna Prizren , Kontratën e shitblerjes të datës 28/08/1963 ndërmjet A. Z dhe “K” Prizren lidhur ngastrat kadastrale nr. 403 fleta poseduese 1102 Komuna Prizren dhe Kontratën e shitblerjes të datës 28/08/1962 ndërmjet A. Z dhe “K” Prizren lidhur ngastrën kadastrale nr. 40 fleta poseduese 145 Komuna Prizren .

Në seancën degjimore të mbajtur më 02/06/2004 paditesit precizuan padinë e tyre në aspektin objektiv duke kërkuar zëvendësimin e ngastrave të kërkuar me padinë fillestare me ngastrat kadastrale nr. 497 ;500 dhe 610.

Më 27/04/2009 e paditura parashtroi përgjigje ndaj padisë . Sipas të paditurës paditësit nuk kanë pohuar vlerën e kontestit , me Aktgjykimin C.nr. 383/95 të datës 21/12/1995, pika –II- e dispozitivit tani më është res Judicata. E paditura gjithashtu konteston ekspertizën e ekspertit gjeodet si dhe atë të ekspertit të bujqësisë.

Më 07 maj 2009, Gjykata Komunale në Prizren e kishte marrë Aktgjykimin C.nr. 347/03, me të cilin aprovet kërkesëpadia e paditësve, dhe obligohet e paditura NSH: K “P” në Prizren, që për ndërrim të dorëzohet në posedim parcelat kadastrale: nr. 497 në sipërfaqe prej 0.65,17 ha sipas listës poseduese nr.263 ZK , dhe parcela nr. 500 në sipërfaqe prej 0.27,59 ha, sipas listës poseduese nr. 263 ZK Lj.

Me datë 20.02.2010, NSH. K “P”, paraqet ankesë kundër Aktgjykimit C.nr. 347/03, në Gjykatën Komunale në Prizren për Gjykatën e Qarkut në Prizren. Ajo propozon që Gjykata e Qarkut, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës , ta bëjë ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale C.nr 347/03, dhe ta kthejë lëndën në Gjykatën e Shkallës së parë për rishqyrtim, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës, aplikim të gabuar të ligjit dhe vërtetimit të pa saktë dhe të pa plotë të gjendjes faktike.

Me datë 22.02.2010, AKP-ja parashton ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.347/2003 të datës 07.05.2009. AKP-ja pohon se Gjykata Komunale në Prizren nuk ka qenë kompetente, për ta shqyrtuar padinë e paditësve, sepse për këtë kompetente është Dhoma e Posaçme, dhe se është dashur ta shpallë veten jo kompetente për vendosje në këtë çështje juridike, në pajtim me nenin 17,18,19 të LPK-së. Andaj AKP-ja kërkon nga Gjykata e Qarkut që të pranojë ankesën e AKP-së në tërësi, dhe të anulohet Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr 247/03.

Me datë 08 shtator 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren, sipas shkresës përcjellëse Ac.nr. 122/2010, referon çështjen për vendosje dhe për shqyrtim të pretendimeve ankimore, duke u bazuar në kompetencën e Dhomës së Posaçme.

Me datë 25 maj 2012, Kolegji i Specializuar i DHPGJS lëshon Aktvendimin me nr. SR-11-0216, me të cilin lënda e shkallës së parë e Gjykatës Komunale të Prizrenit, me nr. C.nr. 347/2003, dhe lënda ankimore e Gjykatës së Qarkut në Prizren, me nr. 122/2010, tërhiqen nga Gjykata e Qarkut në Prizren për t'u gjykuar nga Dhoma e Posaçme.

Me datë 24 tetor 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, urdhëron Zyren e Regjistrimit, që lëndën C-III-12-0902 ta regjistrojë me numër të ri të lëndës, pranë Kolegjit të Apelit, në pajtim me vendimin e Presidiumit nr. 21/2013 të datës 26 Korrik 2013.

Me datë 24 tetor 2014, Zyra e Regjistrimit e regjistron lëndën me numrin e ri AC-II-14-0049.

Me datë 12 mars 2020 ankesat dhe dokumentacioni përcjellës, të paraqitura nga të paditurat/ankueset, i dorëzohen përfaqësuesit të paditësve. Nuk është parashtruar përgjigje ndaj ankesës.

Arsyetimi juridik:

Ankesat janë të bazuara.

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit .

Juridiksioni i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme është i rregulluar me nenin 5 të Ligjit nr. 046/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kolegji i Apelit konstaton se kjo padi nuk ishte e referuar nga Dhoma e Posaçme asnjëherë, dhe rrjedhimisht kjo gjykatë kishte vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë në zbatim në Dhomën e Posaçme, dhe në kundërshtim me nenin 182, paragrafi 2, pika (f) e LPK-së.

Meqenëse lënda në fjalë ka pasur të bëj me një ndërmarrje shoqërore, KBI "P", Prizren me të cilën ka administruar AKM tani Agjencia Kosovare e Privatizimit, sipas nenit 4.1 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 datë 13 qershor 2002 (e ndryshuar me Rregulloret nr. 2008/04 dhe 2008/19), ishte nën juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme, tani nën juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme (neni 5.1.1.4 të Ligjit për nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme).

Lënda nuk ishte referuar nga Dhoma e Posaçme tek Gjykata Komunale në Prizren, andaj përfundimisht Gjykata Komunale nuk kishte juridiksion mbi lëndën

Kjo gjykatë ka qenë e obliguar që në bazë të nenit 17, paragrafi 1 i LPK-së, ex officio të trajtoj nëse është kompetente për të gjykuar rastin e parashtruar para saj ose jo. Në këtë mënyrë, në zbatimin e procedurave gjatë vendimmarrjes, kjo gjykatë ka marrë Aktgjykimin e kundërshtuar, me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Për arsyet e lartpërmendura, Kolegji i Apelit, nuk mund të vërtetoj asnjë vendim me shkelje të tilla procedurale, andaj është e obliguar që t'i (anuloj)shpallë që aktgjykimin C.nr. 347/03 të datës 07 maj 2009 të shpall nul dhe pa efekt juridik.

Në bazë të nenit 5, paragrafi 3 i LDHGJS-së, as Dhoma e Posaçme e as kolegjet apo gjyqtarët e saj, nuk do të kenë asnjë autoritet, për t'i referuar ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë, apo rast specifik që është kompetencë primare e tyre, tek gjykatat e tjera në Kosovë.

Për këtë arsye, duke mos paragjykuar epilogun përfundimtar të kësaj padie, Kolegji i Apelit lëndën e dërgon në gjykim në shkallë të parë të i DHPGJS-së.

Andaj konform nenit 9.10 të LDHPGJS-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore:

Nuk caktohen tasat gjyqësore për procedurën ankimore, sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive për lëndët në pritje.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më 16/07/ 2020

Ilmi Bajrami , Gjyqtar Kryesues
